Kronikë

Sherr pranë zyrës së PSD në Tiranë, thuhen xhamat! Babë e bir në kërkim, gjenden 2 fishekë të paplasur në rrugë! Partia e Doshit: S'ka lidhje me ne

Policia e Tiranës u njoftua përmes një telefonate në sallën operative për njëri konflikt në ambientet e zyrës së partisë së Tom Doshit, PSD te zona e Ali Demit në Tiranë rreth orës 14.00.

■ Sherri në zyrën elektorale në 'Ali Dem'/ Reagon PSD: Nuk ka lidhje me aktivitetin tonë politik

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Sokol Dema
29 Prill, 14:35 | **Përditësimi: 29 Prill, 16:39**

Share

TIRANË- Policia e Tiranës u njoftua përmes një telefonate në sallën operative për një konflikt në ambientet e zyrës së partisë së Tom Doshit, PSD te zona e Ali Demit në Tiranë rreth orës 14.00. Kur policia mbërriti gjeti të thyera xhamat e zyrës elektorale, dyshohet me sende të forta.

PSD reagoi publikisht duke thënë se incidenti nuk ndodhi brenda zyrës, por pranë ambienteve të tyre. Asnjë anëtar apo simpatizant i saj nuk u përfshi në konflikt – thotë PSD e cila mohoi që ngjarja të lidhet me aktivitetin e partisë. Pas dëshmive të mbledhura, policia shpalli në kërkim dy persona, babë e bir, të cilët pas konfliktit ishin larguar me automjet.

Arjan Telhallari dhe djali i tij dyshohet te kenë qenë të armatosur, por pistoleta nuk është përdorur. Në rrugë jashtë zyrës së PSD-së gjetën vetëm dy fishekë të paplasur që mendohet t'i kenë rënë të dyshuarve.

LEXO EDHE:
Pas PS-së dhe PD depoziton ankesë në KQZ për votën e emigrantëve: Është shkelur protokolli i DHL të hetohet nga SPAK

Ende nuk janë të qarta motivet e këtij konflikti pranë zyrës elektorale. Burimet thonë se i riu në kërkim më herët të jetë konfliktuar me një person dhe pas sherrit të ketë thërritur babanë. Policia thotë se vijon hetimet për zbardhjen e motivit të konfliktit dhe dokumentimin e rrethanave të rastit.

> ***Njoftimi i policisë:***
>
> *Rreth orës 14:00, në sallën operative të DVP Tiranë ka ardhur një telefonatë se në rrugën "Ali Demi" kishte një konflikt midis disa shtetasish, në ambientet e një zyre elektorale.*
>
> *Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, është konstatuar i dëmtuar dyshohet me sende të forta xhami i zyrës së subjektit elektoral.*
>
> *Po nga këqyrja e vendit të ngjarjes, janë konstatuar dy fishekë luftarak.*
>
> *Menjëherë në vendin e ngjarjes, kanë shkuar forca të shumta policie dhe grupi hetimor. Vijon puna për identifikimin dhe kapjen e shtetasve të përfshirë në konflikt, të cilët janë larguar nga vendi i ngjarjes me një automjet.*
>
> *Në drejtimin e Prokurorisë vijon puna për zbardhjen e motivit të konfliktit dhe dokumentimin e rrethanave të rastit.*

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 16:21
Sherri në zyrën elektorale në 'Ali Dem'/ Reagon PSD: Nuk ka lidhje me aktivitetin tonë politik

Partia Socialdemokrate ka reaguar ditën e sotme lidhur me ngjarjen e ndodhur në zonën e 'Ali Demit' në Tiranë, ku disa persona janë përfshirë në një konflikt fizik.

Sipas PSD-së, ngjarja në fjalë nuk ka asnjë lidhje me aktivitetin politik të partisë. Ata shprehen se ngjarja ka ndodhur jashtë ambienteve të zyrës dhe se asnjë anëtar nuk është përfshirë në konflikt.

> *"Partia Socialdemokrate sqaron opinionin publik se ngjarja e ndodhur këtë mesditë në rrugën "Ali Demi" nuk ka asnjë lidhje me zyrën tonë elektorale apo me aktivitetin e Partisë Socialdemokrate.*
>
> *Vendi ku ka ndodhur incidenti ndodhet pranë ambienteve tona, por asnjë nga anëtarët apo simpatizantët tanë nuk ka qenë i përfshirë në konfliktin në fjalë. Dënojmë çdo akt dhune dhe presim që organet kompetente të sqarojnë plotësisht rrethanat."-reagimi i PSD-së.*

H.K/Shqiptarja.com

Share

Xh.K/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Arjan Telhallari sherr Tirane Ali Demi psd zgjedhjet parlamentare 2025 tom doshi

Komento

Komente

Ops: 29/04/2025 15:11

Rëndja e rames me shoke

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .com

Sondazhi i ditës: 27 Prill, 20:48
Si e vlerësoni kontratën 6 mln dollarë të PD për lobim në SHBA?

Normale | Para të dyshimta | Jam ile dyzuar

Lajme të tjera

Shehaj nga Durrësi: Vota jonë nuk preket, do kemi mbi 1 mijë vëzhgues që do filmojnë numërimin
29 Prill, 20:43

'Vota ime dhe e familjes time kurrë më për Metën', Basha i përgjigjet komentuesit: Sakrifica e demokratëve s'mund të përdoret për të njerrë atë nga burgu(VIDEO)
29 Prill, 20:00

PD kallëzon ndërkombëtarët e Prokurorisë e Tiranës kandidatin e PS për Shkodrën, Ervin Doda: Fshehu dënimin me burg
29 Prill, 19:58

Rama ironizon Berishën nga Patosi: Shqipëria do zgjedh mes nesh dhe një 80 e kusur vjeçari që s'di ça flet, do arrijmë fitore rekord në qarkun e Fierit
29 Prill, 19:22

Basha reagon për lobimin e Berishës: E vërteta nuk bëhet me 6 mln dollarë! Nëse s'do e përdorte partinë për hallin e tij personal, sot opozita do ishte në pushtet(VIDEO)
29 Prill, 18:46

Evi Kokalari thirrje Berishës: Bëj publike kontratën me LaCivita dhe Manafort, sa po i paguan, 6 apo 10 milionë dollarë?
29 Prill, 18:31

Kontrata e lobimit të PD/ Spahiu për Report Tv: SHBA nuk blihen me miliona dhe s'të falin për lobimet! Berisha e ka trenin e fundit! KQZ duhet të reagonte! Po aleatët e dinin?
29 Prill, 18:10



Rama ironi me Berishën për kontratën e lobimit: Luli thoshte 7x7= 42, tani doli dhe bufi 7x7= 6 milionë! Sot mund të kishim ende piramidat e Sudes dhe Xhaferrit
29 Prill, 17:48

Rama me të rinjtë në Fier: 11 maji është takim me historinë, zgjedhjet më të rëndësishme! Kemi skuadrën më të re në fletën e votimit
29 Prill, 16:31

Zgjedhjet/ Raporti paraprak i OSBE-ODIHR: Mjedisi politik mbetet i polarizuar, rekomandimet tona s'u plotësuan të gjitha! Për herë të parë vota e diasporës
29 Prill, 16:27

Sherri në zyrën elektorale në 'Ali Dem'/ Reagon PSD: Nuk ka lidhje me aktivitetin tonë politik
29 Prill, 16:21

Meta nga qelia prezanton programin ekonomik: Edi Rama është 'kryegjoba' grabitqare për shqiptarët! Synimi yné të ulim taksat
29 Prill, 13:59

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaktësuar i kesaj faqeje